



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0784

PSH. nr. 784/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Termomontimi” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i palestrës ne Zahaq Ri-Tender “me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejes, me datën 13/12/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik “Termomontimi” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.10.2023 (me numër protokolli 784/23) vendimi i AK për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i palestrës ne Zahaq Ri-Tender “ me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejes, mbetet në fuqi.

2. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 07.04.2023, Komuna e Pejes , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i palestrës ne Zahaq Ri-Tender” me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1”. Nderkaq me datën 26.09.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE“Termomontimi” SH.P.K me datën 02.10.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me 27.09.2023, AK- Komuna e Pejës me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Termomontimi” SH.P.K. . lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndertimi i palestrës në Zahaq Ri-Tender” me numër të prokurimit: “635-23-3456-5-1-1” inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

AK në vendim ka kërkuar të refuzohet kërkesa e propozuar për shqyrtim si e pa baze.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues“Termomontimi” SH.P.K. me datën 12.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 784/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Në fazën e shqyrtimit paraprak

OSHP ka konstatuar se ankesat në rastin konkret janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesit kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesat i përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bijnë nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë konstatohet se Raporti i Ekspertit Shqyrtues është pranuar me 01.11.2023 me rekomandimet si vijon: Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Termomontimi” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 12.10.2023 (me numër protokollit 784/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi i palestrës në Zahaq Ri-Tender “ me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejës. Të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar dhe konstatohet se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP. Prandaj Paneli analizoi në vijim shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe pohimet e tyre konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme dhe ka kushte të vendoset në mënyrë meritore përkitazi me ankesat në rastin konkret, sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Në këtë rast Paneli mori paraprakisht konstatoi se AK ka zbatuar:

a. procedurë të hapur, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.37. të nenit 4, të LPP;

b. lloji i kontratës: Punë, sikurse parashihet me paragrafin 3, të nenit 27, të LPP;

c. vlera e parashikuar e kontratës: 858.509.50 € vlere e madhe, sikurse përkufizohet me paragrafin 1.28 të nenit 4, lidhur me paragrafin 1, të nenit 19, të LPP

Pohimet ankimore të ankuesit

Lidhur me pohimin ankimore se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar planin dinamik në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit. Konstatim i ekspertit shqyrtues është se pas analizimit të pretendimeve ankimore, arsyetimit të AK-së dhe ofertës së OE të rekomanduar, kemi gjetur se I njëjti në planin dinamik në total ka 150 ditë. **Provë** : Plani dinamik në ofertë të OE të rekomanduar. I njëjti plan dinamik sipas tabelës së plotësuar nga OE pavarësisht shprehjes së përdorur nga OE para fillimit të tabelës “150 ditë pune”, I njëjti plan nuk parasheh ditë shtesë apo ditë “jo pune”. Për më tepër, me qëllim të trajtimit të barabartë të OE-ve, ne kemi analizuar edhe ofertën e OE e ankues, e cila sipas vlerësimit tonë është plotësuar në mënyrë të njëjt, dmth duke mos parashikuar ditë “jo pune” dhe në total ka 150 ditë, njëjt si OE ankues Përveq kësaj në këkësia decidive në dosje të tenderit ka qenë si në vijim : “Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: minimim 150 dit deri ne max 250 dit kalendarike”. Përveq kësaj kjo dëshmohej edhe përmes deklaratës së aneksi 7 deklarata e OE për afatin e implementimit të projektit dhe periudhën garantuese, ku decidivisht shënon afati i implementimit të këtij projekti është 150 ditë nga data e fillimit të punëve dhe 6 vite (maksimumi i mundshëm) periudha garantuese. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimore se OE i rekomanduar për kontratë : kriteri i dosjes se tenderit për inxhinierin e elektroteknikes drejtimi energjetike I çertifikuar për efijencë të energjisë nuk përmbushet. Eksperti konstaton se sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi për këtë kriter ka paraqitur dy inxhiniera të elektros. 1. Skender Nitaj. Ky person është inxhinier e elektroteknikes drejtimi Elektronike, ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar drejtimi Energjetike. Pra, nuk përmbushet kriteri I dosjes se tenderit. 2. Sahit Hasani. Ky person është inxhinier I elektroteknikes drejtimi Energjetike, por nuk është I çertifikuar për efijence te energjise sipas kërkesës së DT. Duhet të sqarojmë se OSHP përmes vendimit 401/23, ka obliguar AK-në që për këtë qështje të kërkoj sqarime nga insitucionet universitare. Nga shkresat lëndës nuk kemi gjetur se dëshmi se AK ka ndërmarr një veprim të tëillë, andaj konsiderojmë se vendimi i AK-së nuk është marr në pajtim me kërkesat e vendimit të OSHP 401/23. Po ashtu, nuk kemi gjetur dëshmi se AK ka kërkuar sqarime sipas vendimit të OSHP-së 401/23 sa i përket certifikimit për efijencë të energjisë të inxhinierit te OE (tani ankues), andaj edhe në këtë pikë vendimi i AK-së nuk është marr në pajtim me obligimet e caktuara nga OSHP me vendimin 401/23. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se ka nevojë të mbahet seanca publike me palë dhe për këto lëndë me qëllim të sqarimit sa më në detaje paneli shqyrtues mbajti seancë më datë 01.12.2023. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se lidhur me aktivitetin e “Ndertimi i palestrës ne Zahaq Ri-Tender” me nr. të prokurimit: "635-23-3456-5-1-1", ka pasur vendim të nxjerrur nga OSHP me nr. 2023/0401 më dt. 13.09.2023 Paneli shqyrtues vlerëson

pretendimet ankimore të cilat i ka paraqitur pala me ankesë, janë pretendime të cilat janë shqyrtuar nga ky paneli shqyrtues dhe për këto pretendime paneli në vendimin 2023/0401, ka vepruar duke e mbështetur konstatimin e ekspertit shqyrtues, i cili është i njëjti ekspert shqyrtues në ty dy rastet.

Në këtë rast, duke i krahasuar pohimet ankimore (jo vetëm nga pikëpamja e ekspertit shqyrtues) por në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, konstaton sipas gjykimit të pavarur të tij se, pohimet e ankuesit të cilat e përbejnë lëndën e shqyrtimit në këtë çështje, janë trajtuar dhe me parë dhe atë me Vendimin e OSHP Nr. 2023/0401. Për këtë shkak Paneli e konsideron këtë çështje, tani më çështje të gjykuar, sikurse parashihet kjo shprehimisht me nenin 105, paragrafi 2.15, të LPP, sipas të cilit, cituar: Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”. Aq më tepër, sipas vendimit të cituar është kërkuar (për hirë të objektivitetit dhe paanësisë) që AK përmes rivlerësimit ta bëjë verifikimin e përgjegjshmërisë ankuesit dhe të rekomanduarit. Andaj OSHP e vlerëson këtë çështje si çështje e gjykuar dhe mbetet në diskrecionin e AK (nga cilësia e tij/sajë si entitet i administratës shtetërore) që ta vlerësoj në mënyrë të pavarur nëse duhen ndërmarrë veprime tjera, sikurse parashihet dhe me nenin 59 të LPP. Po ashtu, konstatimin i ekspertit shqyrtues në raportin e tij të datës 01.11.2023 sa i përket pretendimin të dytë është mjaftë kontradiktor në pohimet e tij me raportin paraprak të datës 10.07.2023. Po ashtu siç nuk është i qëndrueshëm deklarimi i ekspertit shqyrtues se *"OSHP përmes vendimit 401/23, ka obliguar AK-në që për këtë çështje të kërkoj sqarime nga insitucionet universitare"* për shkak se e vendimin 401/23 paneli ka konstatuar *"Paneli shqyrtues, duke i analizuar dhe krahasuar pohimet ankimore në raport me ofertën, shpjegimet e ekspertit dhe kërkesat e DT, mendon se zgjidhja më e mirë do të ishte që AK me qëllim të mos diskriminimit apo pabarazisë të kërkoj informacione shtesë konform nenit 72 të LPP, nëse është e nevojshme edhe nga institucionet universitare sa i përket inxhinierëve se a i plotësojnë ndonjëri kushtet e Dosjes së Tenderit"*. Kështu që, jo domosdoshmërishtë ka qenë i obliguar AK që të kërkohej informacionet shtesë nga institucionet universitare

Vlenë të potencohet edhe fakti se autoriteti kontraktues Komuna e Pejës, konkretisht menaxheri i prokurimit ju është drejtuar OSHP dy herë. Herën e fundit më dt. 13.12.2023 me këtë shënim: *"Pershendetje te nderuar/a, po ju shkruaj ne lidhje me aktivitetin Ndertimi i Palestres ne Zahaq RITENDER me nr. te prokurimit: 635-23-3456-5-1-1 ju njoftoje se ne si AK po presim nje Vendim nga ana juaj, pasiqe ju kemi kerkuar Operatoreve ekonomik vazhdimin e validitetit dhe vazhdimin e sigurimit mirepo njeri nga operatoret nuk e ka vazhduar as validitetin dhe as sigurimin e tenderit, pra behet fjale per Operatorin Termomontimi dhe ju lutem qe te na ktheni nje pergjigje sa me te shpejte, pasiqe ne si AK e kemi respektuar Vendimin e pare te Panelit Shqyrtues te Prokurimit duke respektuar gjykimin tuaj ne kete aktivitet"*. Lidhur me këtë paneli shqyrtues në sistemin e eprokurimit nuk është gjetur kërkesa e AK drejtuar operatorëve ekonomik pjesëmarrës sa i përket vazhdimin të validitetit të dytë me radhë sa i përket këtij aktiviteti. Por janë gjeturë se edhe i rekomanduari por edhe ankuesi e kanë vazhduar validitetin e ofertës por nuk dihet se vazhdimi a është bërë brenda afatit të përcaktuar nga AK. Sido që të jetë paneli shqyrtues mendon se mos vazhdimin i validitetit të ofertës (brenda afatit) klasifikohet si palë pa interes sipas nenit 4.1.26 të LPP.

Andaj në dajshtesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj"

Prandaj pa nevojë për shpjegime tjera, Paneli Shqyrtues ka vendosur që ta vërtetoj Vendimin e atakuar të AK për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe të konfiskohen mjetet e deponuara nga ankuesi, në emrin e tarifës ankimore, ashtu sikurse është rregulluar kjo me dispozitën e nenin 31 paragrafi 5 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, me ç'rast mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat dhe pas administrimit të shkresave të kësaj lënde, Paneli ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 98, 99 lidhur me nenin 104 dhe 105 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - TERMOMONTIMI**
- Arkivës së OSHP-së: